



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:237885

Datë: 12.07.2024

Numri i dokumentit: 05935012

Ac.nr.9559/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci – kryetar i Kolegjit, Naime Ahmeti dhe Naim Mehulli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.M nga P....., të cilën me autorizim e përfaqëson B.T, avokat nga P....., kundër të paditurës Ndërmarrja Hidro Ekonomike Publike “Ibër Lepenci” me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, Nr.13, të cilën e përfaqëson N.S, juriste për përfaqësim pranë të paditurës, lidhur me kompensimin e pagave të pa paguara, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.682/18 i datës 07.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Ndërmarrja Hidro Ekonomike Publike “Ibër Lepenci” me seli në P....., Bulevardi “Bill Klinton”, Nr.13, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.682/18 i datës 07.06.2021, VËRTETOHET.

II. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën -IV-, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.682/18, i datës 07.06.2021, ka vendosur si në vijim: *“I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditëses A.M nga P....., DETYROHET e paditura Ndërmarrja Hidro Ekonomike Publike “Ibër Lepenci” me seli në Prishtinë, që paditëses, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të kundër ligjshme për periudhën 15.10.2009 e deri më 20.06.2020, t’ia paguaj paditëses shumën neto prej 71,664.76 €, me kamat në lartësinë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara për një vit, pa destinim të caktuar,*

duke filluar nga data 07.06.2021, data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën përfundimtare, po ashtu DETYROHET e paditura, që të paguaj kontributin pensional në Trustin pensional në emër të punëtores në shumën prej 4,074.43 €, të paguaj kontributin pensional në Trustin Pensional në emër të punëdhënësit në shumën prej 4,074.43 €, si dhe në emër të tatimi në paga që duhet të paguhet në dobi të Buxhetit të Republikës së Kosovës, në shumën prej 5,749.40 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia paguaj çdo muaj shumën prej 899.60 € bruto, në emër të pagës mujore, duke filluar nga data e përpilimit të ekspertizës 23.06.2020 e deri me datë 29.12.2020, datë kjo në të cilën paditësja ka regjistruar biznesin individual si avokate në ARBK, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

III. DETYROHET e paditura, që paditëses për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 1,117.20 €.”

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor, ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar paditësja me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, Aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja ka parashtruar padi në Gjykatës së shkallës së parë me datë 07.12.2009, me objekt të padisë anulimin e vendimit mbi shfuqizimin e kontratës së punësi si dhe kompensimin e të ardhurave personale, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.2708/09 i datës 01.07.2015, me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kundër aktgjykimit të lartcekur ankesë ka parashtruar e paditura në Gjykatën e Apelit, e cila me aktvendimin, Ac.nr.4206/15 i datës 12.02.2018 e ka refuzuar pjesërisht të pa bazuar ankesën e të paditurës dhe e ka vërtetuar aktgjykimin në pjesën me të cilën është anuluar aktvendimi i të paditurës, ndërsa e ka aprovuar pjesërisht të bazuar ankesën e paditëses lidhur me kompensimin e të ardhurave personale duke e kthyer lëndën në rigjykim për këtë pjesë.

E paditura ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme, lidhur me pjesën vërtetuese të aktgjykimit, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin, Rev.nr.160/2018 i datës 18.06.2018, e ka refuzuar revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.4206/15, i datës 12.02.2018.

Pas kthimit në rigjykim vetëm për pjesën e kompesimit të ardhurave personale - pagave, Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me ankesë nga e paditura C.nr.682/18 i datës 07.06.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit të pagave të pa paguara, më konkretisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të këtij aktgjykimi gjykata ka theksuar se ka gjetur se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestues fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, kjo është vërtetuar edhe nga kontrata e punës numër 01-424 e datës 12.03.2009, nga e cila kontratë është vërtetuar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratë pune me datë 12.03.2009, sipas të cilës paditësja do të kryen punën dhe detyrat e punës - shef i kabinetit të drejtorit të përgjithshëm, kontrata lidhet për kohë të caktuar dhe atë nga data 01.04.2009 deri me datë 12.10.2009. Ndërsa nga kontrata e punës numër 1-2443 e datës 31.08.2009, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka vërtetuar se palët ndërgjyqëse kanë qenë në marrëdhënie kontraktuale mes tyre, të cilët me datë 31.08.2009, kanë nënshkruar kontratën me nr. 01-2443 sipas të cilës paditësja do të kryej punën e shefit të kabinetit të drejtorit të përgjithshëm tek e paditura, për kohë të pa caktuar dhe me orar të plotë të punës.

Tutje në arsyetim gjykata e shkallës ka theksuar se nga vendimi mbi shfuqizimin e kontratave numër 01-2606 i dt.15.09.2009, gjykata ka vërtetuar se e paditura me këtë vendim, ka shfuqizuar kontratën e punës nr.01-2443 të datës 31.08.2009, me arsyetimin e vazhdimit të tyre të paligjshëm nga ish autoriteti punëdhënës, duke vepruar para arritjes së skadencës së tyre dhe duke mohuar procedurat e vlerësimit të punës së tyre në kohën e duhur. Ndërsa me kërkesën për shqyrtimin e vendimit të datës 21.10.2009, gjykata ka vërtetuar se paditësja me datë 21.10.2009, i është drejtuar me kërkesë për ri shqyrtim të vendimit 01-2606 të datës 15.09.2009, të paditurës

sipas të cilës kërkon rishqyrtimin e vendimit të lartë cekur dhe kthimi në vendin e punës apo sistemimin në ndonjë njësi tjetër.

Se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe e njëjta është larguar nga puna në mënyrë të kundër ligjshme, Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se është vërtetuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë me C.nr.2708/09 të datës 01.07.2015, me të cilin është anuluar vendimin nr.01-266, të datës 15.09.2009, të cilin aktgjykim gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë me aktgjykimin Ac.nr.4206/2015, të datës 12.02.2018, në pjesën e kërkesë padisë që ka të bëjë me anulimin e vendimit nr.01-266, të datës 15.09.2006, e ka vërtetuar, ndërsa për pjesën e kërkesëpadisë në emër të ndryshimit të pagave, ndryshimit të trustit pensional dhe tatimit në pagë e ka kthyer në rigjykim, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Rev.nr.160/2018 të datës 18.06.2018, e ka refuzuar si të pa bazuar revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër Ac.nr.4206/15 të datës 12.02.2018.

Gjykata e shkallës së parë, ka shtuar se pasi që ka vërtetuar këtë gjendje faktike ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar sepse paditësja dhe e paditura raportin e tyre punëdhënës-punëmarrës e kanë rregulluar me kontratë pune, duke përcaktuar të drejta dhe detyrimet reciproke në mes tyre. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kontrata e punës numër 1-2443 e datës 31.08.2009, e cila kundër ligjshëm është shkëputur është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës, përkatësisht me dispozitat nga neni 11 i Ligjit të Punës. Tutje theksohet se sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë marrëdhënia e punës është marrëdhënie kontraktore ku palët duhet të respektojnë kushte për lidhjen e kontratës. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kontrata e punës e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës është një marrëdhënie kontraktuese e krijuar në tërësi duke i respektuar kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës dhe atë: aftësia punuese të palëve kontraktues, (aftësia e veprimit gjegjësisht mosha madhore), vullnetin e palëve, lënda e kontratës dhe baza e kontratës, e po ashtu sipas Gjykatës së shkallës së parë është rregull i përgjithshëm dhe parim i së drejtës, se palët me vullnetin e tyre të lirë e të shprehur mund të krijojnë raportin juridik gjegjësisht marrëdhënien juridike, por po ashtu me këtë vullnet mund të ndryshojnë marrëdhënien juridike. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kontrata e punës e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës mund të ndryshoj vetëm me vullnetin e shprehur të dy palëve të kontratës, e në rastin konkret kjo kontratë e punës është shkëputur kundërligjshëm nga e paditura.

Nga të lartcekurat e duke iu referuar Ligjit të Punës nr. 03/L-21255, i cili me nenin 55 të par. 1, Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka vendosur që ta aprovoj pjesërisht të bazuar

kërkesëpadinë e paditëses. Për të përcaktuar lartësinë e kërkesëpadisë sipas propozimit të palës paditëse gjykata e shkallës së parë ka nxjerr ekspertizën financiare. Në ekspertizën financiare të datës 29.04.2015, plotësimin e ekspertizës financiare të datës 23.06.2020 si dhe sqarimet e dhëna në seancën e datës 29.04.2021 është konstatuar se paditëses A.M, për tërë periudhën (15.10.2009 deri 20.06.2020) kontestimore sipas llogarisë kishte me realizuar: Paga bruto në vlerë 81,488.60 €, paga neto që duhet paguar punëtores është në shumën prej 71,664.76 €, kontributi pensional që duhet paguar në Trustin Pensional në emër të punëtores është në shumën prej 4,074.43 €, kontributi pensional që duhet paguar në Trustin Pensional në emër të punëdhënësit është në shumën prej 4,074.43 € dhe tatimi në paga që duhet paguar në dobi të buxhetit të Kosovës është në shumën prej 5,749.40 €. Nga administrimi i ekspertizave financiare si prova materiale gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka gjetur se sikur paditësja të mos ishte larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme me vendimin mbi shfuqizimin e kontratës numër 01-2606 i dt.15.09.2009, paditësja do të realizonte të ardhura personale për periudhën kontestuese duke filluar nga data 15.10.2009 gjer me datë 20.06.2020, sipas shumave të cekura si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi me të cilin është detyruar e paditura që paditëses t'ia paguaj çdo muaj shumën prej 899.60 € bruto, në emër të pagës mujore, duke filluar nga data e përpilimit të ekspertizës 23.06.2020 e deri me datë 29.12.2020, datë kjo në të cilën paditësja ka regjistruar biznesin individual si avokate në ARBK, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka vendosur në këtë mënyrë pasi që sipas dispozitave ligjore në fuqi, një ndër të drejtat themelore të punëtorit është paga, të cilën të drejtë paditësja nuk e ka realizuar për shkak të vendimit të kundërligjshëm të paditurës me të cilin vendim paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Lartësia e gjykuar si kompensim i të ardhurave personale gjykata e ka vërtetuar nga ekspertiza financiare e datës 29.04.2015, plotësimin të ekspertizës financiare i datës 23.06.2020 si dhe sqarimet në seancën e datës 29.04.2021 nga ekspertja M.M, ngase sipas ekspertizave të lartë cekur pozita në të cilën do të duhej të punonte sipas kontratës paditësja, realizon të ardhura prej 899.60 € në muaj, andaj e njëjta do të realizonte këto të ardhura deri në momentin kur ka realizuar biznesin e saj individual më datë 29.12.2020 në ARBK. Ndërsa detyrimi që në emër të pagës mujore duke filluar nga data e përpilimit të ekspertizës 23.06.2020 e deri me datë 29.12.2020, datë kjo në të cilën paditësja ka regjistruar biznesin individual si avokate në ARBK, t'ia paguaj çdo muaj shumën prej 899.60 € bruto, është e drejtë e paditëses që rrjedh nga e drejta në pagë pasi që paditësja është larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme.

Gjykata e shkallës së parë, tutje ka shtuar se sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditëses të vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi i ka falur besimin në tërësi ekspertizës financiare të datës 29.04.2015, plotësimit të ekspertizës financiare të datës 23.06.2020 të cilën ekspertizë e ka sqaruar në seancën gjyqësore të datës 29.04.2021 ekspertja Mihrije Morina, në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e pagave të pa paguara për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të kundër ligjshme për periudhën 15.10.2009 e deri më 20.06.2020, kontributin pensional në Trustin pensional në emër të punëtores, kontributin pensional në Trustin Pensional në emër të punëdhënësit, tatimit në paga në dobi të Buxhetit të Republikës së Kosovës, si dhe pagës mujore bruto për arsye se ekspertja financiare ka bërë llogaritjen e pagave dhe kontributeve tjera të papaguara në mënyrë të saktë për periudhën kohore prej datës 15.10.2009 deri 20.06.2020. Ekspertja në mendimin e saj profesional në formë të shkruar dhe tabelore ka sqaruar periudhën kohore të pagave të papaguara, pagën bruto, pagën neto, kontributin pensional, tatimin në paga, ndërsa kur paditësja ka krijuar marrëdhënie të re të punës prej datës 01.01.2010, e deri në përpunimin e ekspertizës i ka llogaritur pagat me diferencë për çdo muaj, ndërsa ka muaj që në punën e re paditësja ka pasur pagë më të lartë se tek e paditura dhe në këto raste nuk i'u ka krijuar diferenca në pagë dhe të gjitha kalkulimet e pagave janë shpalosur në muaj dhe vite në tabelën numër 1, të gjitha këto për secilin muaj veç e veç dhe shumën e tërësishme duke marrë për bazë të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim ka theksuar se duke u bazuar në të lartcekurat dhe dispozitat ligjore të përmendura më lartë vlerësoi se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj vendosi që ta detyroj të paditurën që paditëses t'ia kompensoj në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të kundër ligjshme për periudhën 15.10.2009 e deri më 20.06.2020, t'ia paguaj paditëses shumën neto prej 71,664.76 €, që të paguaj kontributin pensional në Trustin pensional në emër të punëtores në shumën prej 4,074.43 €, të paguaj kontributin pensional në Trustin Pensional në emër të punëdhënësit në shumën prej 4,074.43 €, si dhe në emër të tatimi në paga që duhet të paguhet në dobi të Buxhetit të Republikës së Kosovës, në shumën prej 5,749.40 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbaramit ligjor si dhe paditëses t'ia paguaj çdo muaj shumën prej 899.60 € bruto, në emër të pagës mujore, duke filluar nga data e përpilimit të ekspertizës 23.06.2020 e deri me datë 29.12.2020, datë kjo në të cilën paditësja ka regjistruar biznesin individual si avokate në ARBK, ashtu siç është vendosur në pjesën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. E paditura, duke mos e kryer detyrimin e saj, për pagesën e pagave dhe detyrimeve tjera të vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, rezulton se i ka mbetur borxh paditëses për pagesën e pagave të papaguara për periudhën

kontestuese, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësja e ka cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit.

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë që ndërlidhet me kompensimin e pagës së 13-të, për periudhën kontestuese në shumën prej 4,213.90 €, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka vendosur si në pikën -IV- të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që në vendimin për lejimin e paradhënies (akontacionit) të punësuarve i datës 21.12.2015, i cili është administruar si provë, në pikën 2 të këtij vendimi është konstatuar se: *“të drejtën e marrjes së paradhënies (akontacionit) e kanë të punësuarit të cilët janë në regjistrin e pagave për muajin dhjetor të vitit 2015. Nëse ndonjë i punësuar, i cili gjendet në regjistrin e pagave për muajin dhjetor 2015, nuk ka punuar gjatë tërë vitit, atëherë paradhënia (akontacioni) të llogaritet proporcionalisht me kohën e kaluar në punë gjatë vitit afarist 2015”*. Në anën tjetër pala paditëse gjykatës nuk i ka ofruar prova të mjaftueshme dhe nuk ka propozuar nxjerrjen e provave tjera me të cilat do të vërtetohej e pala e paditur i ka paguar të gjithë punonjësit e vet me pagën e 13 në mënyrë të vazhdueshme, kurse prova e vetme e cila është siguruar nga pala paditëse, vendimin për lejimin e paradhënies (akontacionit) të punësuarve i datës 21.12.2015, flet vetëm për vitin 2015 për punëtorët të cilët gjinden në regjistrin e pagave, ndërsa gjykatës nuk i është ofruar asnjë provë që vërteton se paditësja ka qenë e regjistruar në regjistrin e pagave të vendosur me këtë vendim të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë, ka shtuar se në rastin konkret nuk ka mundur të pranoj pretendimet e paditëses sa i përket pagës së 13 pasi që paditësja nuk ka prezantuar prova me të cilat e vërteton bazueshmërin e kërkesëpadisë, për pjesën e refuzuar, sipas detyrimit që ka pala konform dispozitave nga nenit 7 e lidhur me nenin 319.1 të LPK-së. Paditësja gjykatës nuk i ka ofruar prova tjera me të cilat kishte me vërtetuar bazën dhe lartësinë e kërkesëpadisë, andaj, gjykata vlerësoj se me provat e administruara në këtë çështje juridike kontestimore nuk u vërtetua bazueshmëria e kërkesëpadisë dhe lartësia e saj për pjesën e refuzuar. Provat të cilat u administruan nga ana e gjykatës sipas propozimit të palëve gjykata i vlerëson si tejet sipërfaqësore dhe të pa bindshme në kuptimin e vërtetimit të fakteve mbi bazën e të cilave gjykata do të vendoste ndryshe sepse gjykata nuk mund ta detyrojë të paditurën për një detyrim të caktuar pa qenë paraprakisht i kontraktuar, pasi që kompensimi i pagës së 13 nuk ka qenë i paraparë me kontratën e punës.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim ka theksuar se sa i përket konkluzionit CP.nr.1128/18 i datës 10.12.2018, aktvendimit CP.nr.1128/18 i datës 13.03.2019, aktvendimit A.nr.1727/19 i datës 10.07.2019, aktvendimit CP.nr.1128/18 i datës 09.03.2020, aktvendimit Ac.nr.2003/20 i

datës 30.07.2020, dhe propozimin për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të datës 28.04.2021, vlerëson se këto veprime ligjore kanë të bëjnë me kërkesën e punëtores për kthimin e saj në vendin e punës që është vendosur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë me C.nr.2708/09, të datës 01.07.2015, me të cilin është anuluar vendimin nr.01-266, të datës 15.09.2009, të cilin aktgjykim gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë me aktgjykimin Ac.nr.4206/2015, të datës 12.02.2018, në pjesën e kërkesë padisë që ka të bëjë me anulimin e vendimit nr.01-266, të datës 15.09.2006, e ka vërtetuar, ndërsa edhe Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Rev.nr.160/2018 të datës 18.06.2018, e ka refuzuar si të pa bazuar revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër Ac.nr.4206/15 të datës 12.02.2018.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me rastin e vendosjes ka marrë për bazë edhe kundërshtimet tjera të palës së paditur, mirëpo nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe, ndërsa në seancën gjyqësore të datës 29.04.2021, e ka refuzuar propozimin e palës së paditur që gjykata zyrtarisht të kërkojë nga Banka Qendrore e Kosovës, paditësja ku ka të hapura llogari në bankat komerciale për arsye se ekspertja financiare ekspertizën dhe plotësimin e ekspertizës, e cila është administruar si provë i ka bazuar në pasqyrat e llogarisë (Trust), e që janë dokumente zyrtare, nga të cilat dokumente edhe janë përpiluar ekspertizat duke u shërbyer me pasqyra që vërtetojnë ku ka punuar paditësja dhe cila ka qenë paga të cilën e ka realizuar paditësja, e që pasqyra e llogarisë për periudhën 01.01.2009 deri me datë 26.05.2020, i është bashkëngjitur ekspertizës financiare.

Për kumatën gjykata e shkallës së parë ka vendos duke u mbështetur në dispozitat e nenit 277 të LMD-së, ndërsa vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449 dhe 452, të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohet shpenzimeve, për përpilimin e padisë në shumën prej 156.00 €, për të ekspertizën financiare shumën prej 150.00 €, për gjashtë seanca gjyqësore të mbajtura për secilën nga 135.00 €, e gjithsejtë shumën prej 1,117.20 €.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të Aktgjykimit, për arsye se Aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e sidomos nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK-së, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi se e paditura me ankesë pretendon se aktgjykimi i goditur i Gjykatës së shkallës së parë, është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, por në fakt e paditura nuk e ka specifikuar asnjë shkelje esenciale që eventualisht e pretendon më ankesë, respektivisht e paditura nuk e ka konkretizuar se në çka konsistojnë shkeljet e pretenduara, andaj meqenëse kjo Gjykatë nuk gjeti se ekzistojnë shkelje absolute të dispozitave të LPK-së, për të cilat Gjykata ankimore, kujdeset sipas detyrës zyrtare, nuk do të lëshohet më tutje në raport me këtë bazë ankimore, të paditurës sepse është pretendim i përgjithësuar dhe pa ndikim në vendimmarrje.

Gjykata ankimore, vlerësoi pretendimin e të paditurës se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykitimit të ankimuar, nuk i ka marr parasysh udhëzimet që kanë rezultuar nga Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac.nr.4026/2015 i datës 12.02.2018, se paditësja përgjatë periudhës kontestuese, a ka qenë duke punuar në ndonjë institucion tjetër dhe a ka krijuar të ardhura. Ky pretendim i të paditurës është në tërësi i pabazuar sepse me ekspertizën financiare të datës 23.06.2020, e punuar nga ekspertja financiare M.M dhe sqarimet e dhëna nga e njëjta në seancën e datës 29.04.2021, është konstatuar se llogaritja e të ardhurave personale është bazuar në Trustin Pensional të Kosovës, në të cilën është pasqyra çdo e hyr e realizuar për një punëmarrës në Republikën e Kosovës, siç është paditësja në këtë rast. Në rastin lëndor llogaritja e të ardhurave personale për paditësen është bërë për çdo muaj, siç mund të shihet dhe konstatohet nga tabelat e kalkulimit në ekspertizën financiare, duke filluar nga faqja 3 (tre) e deri të faqja 8 (tetë), në të cilën ekspertizë për çdo muaj, lidhur më periudhën kontestuese Janar 2010 – Qershor 2020, është bërë llogaritja dhe janë pasqyruar të ardhurat e paditëses, ashtu që në rubrikën e dytë të tabelave ku është përshkrimi *“Bruto paga për muaj për pozitën THE URBANINSTITUTUE BRANCH PFFICE IN KOSOVO DHE ASCOIAZIONE O KOMUNAVE TE KOSOVES”*, sqarohet në mënyrë specifike për secilin muaj se paditësja a ka krijuar të ardhura personale, sa ka krijuar të ardhura personale, sa është diferenca nëmes të ardhurave personale të krijuar dhe atyre që do ti kishte realizuar tek e paditura sikur do të ishte duke punuar dhe sqarimet për secilin muaj a ka punuar apo nuk ka punuar tek ndonjë institucion tjetër dhe në gjitha rastet – muajt, kur paditësja ka punuar dhe ka krijuar të ardhura personale, nuk janë kalkuluar në ekspertizë financiare, por është kalkuluar vetëm diferenca në rast se të ardhurat e krijuar nga paditësja kanë qenë më të vogla sesa të ardhurat që do ti krijonte paditësja tek e paditura, mirëpo siç konstatohet nga ekspertiza e lartcekur ka pas muaj që paditësja ka realizuar të ardhura mujore edhe më shumë se sa paditësja do ti krijonte sikur të ishte duke punuar tek e paditura, edhe këta muaj – të ardhura nuk janë kalkuar më rastin e hartimit të ekspertizës financiare, por janë kalkuluar dhe llogaritur vetëm të ardhurat që e paditura nuk i ka realizuar dhe diferenca e tyre

kur të hyrat mujore të paditëses kanë qenë më të ulëta sesa të hyrat mujore, që do ti realizonte nga e paditura. E në anën tjetër e paditura lidhur me llogaritjen e të hyrave të paditëses e ka pas mundësinë që të propozon edhe ndonjë ekspertizë të re financiare, në fazën e procedurës kur ekspertja ka dhënë sqarime plotësuese në seancën e datës 29.04.2021, por e paditura nuk e ka bërë ndonjë propozim për nxjerrjen e provës eventuale me ekspertizë të re financiare, por e njëjta vetëm ka theksuar se nuk ka pyetje tjera për ekspertin që ishte prezent në seancën e datës së lartcekur, dhe ka vërejtje në ekspertizën financiare, pa e njoftuar gjykatën në mënyrë konkrete se çfarë vërejtje ka, andaj ky pretendim i paditurës është i pabazuar dhe i pa mbështetur në prova shkresore.

Gjykata ankimore, vlerësoi edhe pretendimin e të paditurës në ankesë se gjykata e shkallës së parë, nuk e ka aprovuar propozimin që sipas detyrës zyrtare të kërkohet nga BQK-ja, në raport më paditësen, se a ka krijuar të ardhura tjera për periudhën kontestuese, përveç atyre të pasqyruara në trustin pensionale, andaj sipas të paditurës nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike. Këtë pretendim të paditurës kjo gjykatë e vlerëson si të pa qëndrueshëm sepse gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në udhëzimet që kanë rezultuar nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.4026/2015 i datës 12.02.2018, e ka ftuar në sqarime plotësuese ekspertin financiare, e cila e ka hartuar më shkrim ekspertizën financiare të datës 23.06.2020, ashtu që në seancën e datës 29.04.2021, e njëjta ka sqaruar se në Trustin Pensional të Kosovës, pasqyrohet çdo e hyr e realizuar nga një punëmarrës në Republikën e Kosovës, mbi të cilat të hyra edhe është bazuar ekspertiza financiare. Prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka vlerësuar si të pabazuar propozimin të paditurës që të kërkohen të dhëna për të hyrat mujore të paditëses nga BQK-ja, për të cilin propozim të paditurës, më të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka vendosur më aktvendim e marr në seancën e datës 29.04.2021, të cilën vendimmarrje e përkrah edhe kjo gjykatë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se meqenëse paditëses në mënyrë të kundërligjshme i është ndërprerë marrëdhënia e punës siç edhe është konstatuar më aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.4206/15 i datës 12.02.2018 dhe me aktgjykimin, Rev.nr.160/2018 i 18.06.2018, të njëjtes i takon edhe kompensimi i pagës konform nenit 80 par.1 nën par.1.1 të Ligjit të Punës. Gjykata e Apelit shumat e aprovuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë i aprovon edhe kjo Gjykatë pasi që këto shuma janë aprovuar duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar, e të cilën ekspertizë kjo Gjykatë e vlerëson si objektive, profesionale dhe në përputhje edhe me shkresat e tjera të lëndës.

Lartësia e kompensimit të pagave është vërtetuar përmes ekspertizës përkatëse financiare, e cila është objektive, profesionale dhe e hartuar mbi bazën e dokumentacionit që i referohet lartësisë së pagave që paditësja do ta realizonte sikur të njëjtës mos t'i ndërpritej marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme.

Meqenëse Gjykata e Apelit gjeti se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, kjo Gjykatë vlerëson se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës, andaj nuk gjeti asnjë arsye që të merr një vendim ndryshe nga ai sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e mbështetur aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pika -IV-, e dispozitivit të aktgjyimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë nuk është shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.9559/2021 me datë 11.07.2024

Kryetari i Kolegjit
Adnan Konushevci, d.v